



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
**Komisioneri**

Nr. 697 / Prot.  
14

Tiranë, më 22/7 /2013

**Lënda:** Rekomandim për kontrolluesin Institucionit Arsimor  
Parauniversitar jo publik "Nehemia" me adresë Buçimas Pogradec.

**REKOMANDIM**

**Nr. 12 datë 22/7 2013**

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Institucionit Arsimor Parauniversitar jo publik "Nehemia" Komuna Bucimas Pogradec.

**KONSTATOVA**

Në datë 18/06/2013 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, Institucionit Arsimor Parauniversitar jo publik "Nehemia" Komuna Buçimas Pogradec me objekt:

- Ligjshmëria e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale prej kontrolluesit Institucionit Arsimor Parauniversitar jo publik "Nehemia", në lidhje me kategorinë e subjekteve të të dhënave personale "nxënës", bazuar në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Kontrolluesi Institucioni Arsimor Parauniversitar jo publik "Nehemia" i ndodhur pranë Komunës Buçimas Pogradec si institucion arsimor mbështet punën e tij mbi ligjin 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në

*Republikën e Shqipërisë*” dhe mbi të gjitha dispozitat normative për arsimin parauniversitar.

Në këndvështrimin të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, kontrolluesi shkolla *“Nehemia”* në ushtrim të aktivitetit të tij merr cilësinë e kontrolluesit jo publik, pasi gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij arsimor mbledh dhe përpunon të dhëna personale dhe sensitive të subjekteve të të dhënave personale *“nxënës”*. Sipas përkufizimit në ligj *“Kontrollues”* është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

Gjatë kontrollit administrativ të ushtruar pranë këtij kontrolluesi, hetimi administrativ u zhvillua për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale *“nxënës”* lidhur me faktin se si respektohen nga ky kontrollues kushtet dhe kriteret ligjore të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, si dhe udhëzimi nr.4 datë 16/02/2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për *“ Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”*, gjatë procesit të mbledhjes përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale për këtë kategori subjektsh.

Rezultoi nga kontrolli administrativ se mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale *“nxënës”* nga kontrolluesi shkolla *„Nehemia”* bëhet në rrugë manuale dhe elektronike, për mbledhjen e të dhënave personale në rrugë manuale kontrolluesi ka hartuar vetë, *“formularë aplikimi për regjistrim”* të nxënësve, nëpërmjet të cilit mbledh të dhënat personale, si dhe më pas harton *„kontratat e regjistrimit”*.

Nëpërmjet *“formularit të aplikimit për regjistrim”* kontrolluesi mbledh nga subjektet e të dhënave/nxënës të dhënat e tyre personale si; *emër, mbiemër datëlindje, vëndlindje, nr. telefoni të tij dhe të prindrit, adresa vendi ku banon, mbledh të dhëna per prindërit , emri i prindrit, nënës babait, punësimi, shkolla 9-vjeçare nga vjen, nënshkrimi dhe data e nënshkrimit nga prindi* dhe nëpërmjet *„kontratës për regjistrim”* kontrolluesi mbledh përseri të dhëna personale që lidhen me subjektet e të dhënave *„nxënës”* dhe prindërit e tyre si dhe përcaktohen në këtë kontratë të drejtat dhe detyrimet reciproke. Sa i përket kategorisë së të dhënave personale vlerësojmë se të dhënat personale që kontrolluesi mbledh për kategorinë *“nxënës”* nëpërmjet *„formularit për regjistrim”* dhe *„kontratës regjistrimit,* ato janë të ligjshme, të mbledhura për qëllim specifik, të mjaftueshmë dhe jo në tejkalim të qëllimit.

Nga kontrolli administrativ u konstatua se kontrolluesi shkolla *„Nehemia”* ka krijuar kushte të përshtatshme për ruajtjen e dokumentacionit fizik i cili përmban të dhëna personale të subjekteve të të dhënave *“nxënës”*. Dokumentacioni është i vendosur në dollapë me akses të kufizuar (mbyllje me çelës), zyra me akses të kufizuar (derë me çelës), siguri nga lagështira apo zjarri si dhe ruajtje e ambienteve fizike me roje.

Kontrolluesi shkolla „Nehemia” mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale dhe në rrugë elektronike duke krijuar një regjistër të thjeshtë elektronik në formatin “EXEL”, duke përdorur të dhënat e mbledhura manualisht për kategorinë “nxënës” (subjekte të të dhënave personale), në funksion të qëllimit dhe punës së tij. Lidhur me këtë lloj përpunimi të dhënash vlerësojmë se kontrolluesi ka disa masa sigurie duke kufizuar aksesin në kompjuter me anë të “emrit të përdoruesit” dhe “fjalëkalimit” përkatës. Konstatohet gjithashtu se është instaluar antivirus në të gjithë kompjuterat këtij kontrolluesi.

Pavarësisht sa më sipër nga kontrolli administrativ i zhvilluar pranë kontrolluesit shkolla Nehemia” u konstatua se:

- Kontrolluesi “Institucioni Arsimor Parauniversitar Jo-Publik “Nehemia”, nuk ka të hartuar rregullore për “Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale”.

Nuk është respektuar neni 27 dhe 28 i ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (i ndryshuar), si dhe Udhëzimi nr. 4 datë 16/02/2010, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për “Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”.

- Gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale për kategorinë “nxënës”, kontrolluesi “Institucioni Arsimor Parauniversitar Jo-Publik Nehemia”, ka hartuar formularë aplikimi dhe kontrata në të cilat nuk gjenden të shprehura qëllimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale, marrja e pëlqimit për mbledhjen dhe përpunimit të të dhënave (nga prindërit) si dhe informimi i subjekteve të të dhënave.

Nuk respektohen nenet 5, 6 dhe 18 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (i ndryshuar).

Sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative,

## REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi Institucionit Arsimor Parauniversitar jo publik “Nehemia” Komuna Buçimas Pogradec, të hartojë rregullore të veçantë lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.
2. Në zbatim të neneve 5, 6 dhe 18 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, Udhëzimit të veçantë nr. 4 datë 16/02/2010, i Komisionerit për Mbrojtjen e të

Dhënave Personale për *“Marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”*, të shprehë në *“formularët e aplikimit për regjistrim”* dhe në *“kontratën e regjistrimit”*, në mënyrë të shkruar, qëllimin e saktë, të qartë dhe specifik, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale për kategorinë *“nxënës”*(subjekte të të dhënave personale), si dhe të bëjë informimin e këtyre subjekteve të të dhënave personale.

3. Kryerja e detyrave të lëna në këtë Rekomandim, të realizohet brenda një afati kohor prej 2 (dy) muaj, duke filluar ky afat nga dita e marrjes dijeni të këtij rekomandim.
4. Kontrolluesi Institucionit Arsimor Parauniversitar jo publik *“Nehemia”*, mbas përmbushjes së këtyre rekomandimeve mbart detyrimin për të njoftuar Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Në rast mospërmbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 *“ Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit ”Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”*.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA ÇABEJ (POGAÇE)**

